



Syri.net
Dëshironi të njoftoheni për lajmet e fundit?

by Webpushr

JO

PO




EDICIONI I KOSOVËS



Shpëzimet e Edi Ramës



ARTAN HOXHA
Shpenzime buxhetore marramendëse për fitoren e zgjedhjeve



Armë zjarri, radio-marrëse, llamba për .../ Arrestohen dy persona për kultivim kanabisi në Lezhë

16:37, 25/05/2021



Policia e Lezhës ka arrestuar dy shtetas të cilët merreshin me kultivimin e kanabisit në zonën e Lezhës. Gjatë arrestimit këtyre personave u janë sekuestruar edhe armë zjarri, radiomarrëse, si edhe kubikë për mbjelljen e kanabisit

Mirditë, Lezhë

LEXO EDHE:

Arrestohen dy shqiptarë me 38 kg drogë, sapo kishin kaluar në Janinë nga pylli

Finalizohet operacioni policor i koduar "Bulshar", për goditjen e tentativës për kultivim të bimëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje.

Operacioni nga DVP Lezhë dhe Komisariati i Policisë Mirditë, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethi Gjyqësor Lezhë.

Vihen në pranga 2 shtetas, autorë të tentativës për kultivimin e bimëve narkotike dhe posedues të armëve të zjarrit.

Sekuestrohen 2 armë zjarri, radio marrëse-dhënëse si ato të Policisë, kubikë me fara narkotike kanabis, llamba elektrike termale dhe pajisje të tjera që shërbenin për kultivimin e bimëve narkotike.

Strukturat policore në DVP Lezhë, në vijim të punës së pandërprerë për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë së paligjshme të kultivimit të bimëve narkotike, pas informacioneve të marra në rrugë operative se në zonën e Bulsharit, Mirditë, disa persona po tentonin të kultivonin bimë narkotike, në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pas një hetimi disajavor, kanë finalizuar me sukses operacioni policor të "Bulshar", si rezultat i të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

-D. N., 30 vjeç, banues në Thumanë dhe K. Gj., 21 vjeç, banues në Bulshar, Mirditë.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në vendin e quajtur "Bulshar", Njësia Administrative Orosh, Mirditë, në një serë, kishin kultivuar në kubikë dhe në tokë fidanë narkotike kanabis.

Gjatë kontrollit të ushtruar nga shërbimet e Policisë në një ambient që këta shtetas kishin përshtatur për strehim u gjetën dhe sekuestruan 2 armë zjarri automatikë, 2 radio marrëse-dhënëse si ato të Policisë dhe pajisje të ndryshme elektrike që shërbenin për kultivimin e bimëve narkotike.

Vijon puna për identifikimin dhe kapjen e autorëve të tjerë të implikuar në këtë aktivitet kriminal.

Materialet procedurale u referuan në Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për veprat penale "Kultivim i bimëve narkotike" kryer në bashkëpunim dhe "Armëmbajtja pa leje".

© SYRI.net

Lexo edhe:



Çmontohet banda e shqiptarëve/ 62 grabitje në banesa në veri të Italisë



Austria dëbon shqiptaren e martuar me një vendas sepse e ka banesën e vogël



Shqiptarët kapen me qindra mijëra paund në banesë/ Përdornin rrjetin e koduar Encrochat

Komentet


Shto koment

Posto

më të lexuarat



Dhunoi bashkëshorten, prangoset 50 vjeçari në Himarë



Arrestohet 19 vjeçari në Fier, policia i gjeti ne shtëpi drogë



EMRAT/ Motori përplasat me makinën, vdes i riu plagoset shoku i tij



Përplasi me makinë punëtorin e rrugës, gjykata merr vendimin për 67-vjeçarin



Shkatërrohet karteli i drogës, arrestohen shqiptarë dhe kolumbianë



EMRI/ Shpërdoroi detyrën e saj lidhur me aktin noterial drejt shtetasit të huaj, procedohet noterja



Ngjarja që tronditi Tiranën/ A u vetëvra Eugert Lazaj? Nisin hetimet



BERAT/ Akuzohen për krime mjedisore, tre persona nën hetim



Grabitja me dhunë e çiftit në Lezhë/ Banorët: Policia të jetë prezente

TË NGJASHME



Plagosja e 19 vjeçarit në Tiranë/ Kush janë 2 vëllezërit e rrezikshëm të shpallur në kërkim



Plagosja në Vlorë/ Autori e qëllloi në këmbë duke i lënë mesazh nga dikush tjetër



Plagosja e rëndë në Vlorë/ Ja kush është 18 vjeçari i shpallur në kërkim



Vrau gruan në sy të fëmijës 3 vjeç, arrestohet shqiptari në Francë



Kush është djali i ish-kampiones në qitje, që qëllloi 19-vjeçarin sot në Tiranë



U gjet brenda në makinë me shqiptarin e vrrarë në Londër, i dyshuari: Më lironi jam i pafajshëm



EMRI/ Zbulohet, ja kush është autori i plagosjes në Tiranë



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net